



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 1225/1387 REGJ.THEM
Vendimi

Nr. 839

Datë 30.03.2022

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTAR : ALBERT MEÇA

asistuar nga sekretare gjyqësore Mimoza Noka, në séancë gjyqësore, sot me datë 30.03.2022, shpall këtë vendim lidhur me çështjen penale që i përket :

AKUZUES : Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përfaqësuar nga prokuror Milan Laskaj.

KUNDËR

I PANDEHUR : Marios Dyli, i biri Bilbil dhe Margarita, i dtl 28.12.1996, lindur dhe banues në Drenovice, Berat, Rr. “Zenel Zeka” ose Tiranë, me shtetesi e kombesi shqiptare, me arsim te mesem, me gjendje civile beqar, i padenuar me pare, hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, mbrojtur nga Av.Aldor Hysenlikaj.

AKUZUAR : Për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike” parashikuar nga neni 283 pg.1 i kodit penal.

Në diskutimin përfundimtar palët kërkuar :

Prokuroria : Deklarimin fajtor te te pandehurit Marios Dyli per vepren penale “Prodhim dhe shitja e narkotikeve” të parashikuar nga neni 283/1 te K.Penal dhe denimin e tij me 5 (pese) vjet burgim. Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale, uljen e 1/3 se denimit te dhene duke e denuar te pandehurin Marios Dyli me 3 (tre) vjet e 4 (kater) muaj burgim burgim. Ne aplikim te nenit 59 te K.Penal, pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim per te pandehurin Marios Dyli dhe venien ne prove te tij për një periudhë 4 vjecare. Detyrimin e te pandehurit per pagimin e shpenzimeve proceduriale dhe gjyqesore.

I pandehuri deklaroi se është i penduar.

Avokati kërkoi aplikimin e nenit 59 të Kodit penal.

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e palëve, shqyrtoi provat dhe çështjen në tërësi

VËREN

Se organi i prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur kërkesën për gjykimin e të pandehurit Marios Dyli duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale të mbajtjes dhe shitjes së lëndëve narkotike parashikuar nga neni 283 pg.1 i kodit penal, sipas së cilit :

“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.”

Nga ana e palëve në proces nuk pati pretendime lidhur me juridiksionin apo kompetencën dhe nga ana e Gjykatës nuk u konstatuan kryesisht pengesa procedurale në gjykimin e kësaj çështjeje. Nisur nga masa e dënimit e parashikuar nga dispozita për të cilën akuzohet i pandehuri, në zbatim të nenit 13 të Kodit të Procedurës Penale, çështja u gjykua nga një trup gjykues i përbërë nga gjyqtar i vetëm.

Nga ana procedurale, i pandehuri Marios Dyli, asistuar edhe nga avokati i tij, kërkoi të procedohet me gjykim të shkurtuar. Duke qenë në këto rrethana, Gjykata vlerëson se duhet zbatuar neni 332/dh germa c) i K.pr.penal, sipas të cilit : *“ Pasi dëgjon diskutimet e palëve, Gjykata vendos : ... c) të ftojë palet të paraqesin diskutimet përfundimtare kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi. Palët kanë të drejtë të kërkojnë një afat për t’u përgatitur, jo më të gjatë se 15 ditë”.*

Gjykata vendosi të pranojë kërkesën e të pandehurit dhe të procedojë ndaj tij me gjykim të shkurtuar, qëndrim i cili është mbajtur edhe në Vendimin Unifikues nr 2 datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: *“Këtij gjykimi në dallim nga gjykimi i zakonshëm i mungon faza e marrjes së provave dhe kërkesat lidhur me pavlefshmërinë e tyre. Ligji parashikon që çështja zgjidhet në gjendjen që janë aktet, që nënkupton pranimin e tyre nga palët, ashtu sikurse janë. Gjykimi vazhdon me paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare, të cilat i referohen akteve të pranuar nga palët ashtu sikurse parashikon neni 405/5 dhe 6 i K.Pr.Penale dhe gjykata jep vendim bazuar në to.”*

Sipas pretendimeve të prokurorisë, rezulton se :

Me date 02.09.2021, rreth ores 01.00, nga ana e punonjesve te policise te Sektorit te Forces se Posacme “Shqiponjat”, Drejtoria Vendore e Policise Tirane, duke patrulluar ne Bulevardin “Bajram Curri”, Tirane, kane ndaluar nje automjet autoveture, me targe HX60CUC, me drejtues shtetasin Muharrem Hakeli dhe pasagjer ne sediljen e pare shtetasi Marios Dyli, ne serdiljet e pasme shtetasit Endri Shuaipi dhe Eda Asllanaj. Policia ka ushtruar kontroll automjetit dhe gjate kontrollit fizik, ne canten e shtetasit Marios Dyli jane gjetur dy qese plastike transparente ku brenda kishin material pluhur te bardhe e dyshuar si lende narkotike e llojit Kokaine.

Per dokumentimin e ketij fakti u be peshimi i lendes se dyshuar narkotike. Peshimi u krye me peshore elektronike te markes Adam dhe rezultoi me peshe te pergjithshme me amballazh e kesaj lende ishte 1.8 gram, e cila pas peshimit u fut ne qesen e provave me Nr.UNIK. B20000526, e cila eshte derguar per ekspertim kimik.

Eshte rnarre mostra e urines se personit te dyshuar, shtetasit Marios Dyli, e cila eshte future ne nje vazo plastike dhe eshte mbyllur me tape dhe me pas eshte vendosur ne qesen e provave me nurner UNIK X20000527, e cila eshte derguar per ekspertim toksikologjik.

Eshte pyetur si person ndaj te cilit zhvillohen hetime shtetasi Marius Dyli per vepeen penale "Prodhim dhe shitje te lendeve narkotike" parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe ka deklaruar se lenda narkotike kokaine dhe lenden narkotike nte gjetur nga policia e ka pasur per perdorim vetjak. Lenden narkotike Kokaine e ka blere tek zona e ish-Bllokut nje djali te cilit nuk ia di emrin.

Jane pyetur edhe shtetasit Muharrem Hakeli, Endri Shuaipi dhe Eda Asllanaj te cilet deklarojne se nuk kane qene ne dijeni te faktit se shtetasi Marios Dyli kishte me vete lende narkotike.

Është kryer ekspertimi kimik i materialit te kapur personit nen hetim Marios Dyli dhe sipas aktit të ekspertimit nr. 11632 date 22.11.2021 ka rezultuar se: Analiza e GC/MS per pluhurin objekt ekspertimi tregoj pranine e kokaines. Pesha pa ambalazh e pluhurit eshte 1.507 gram.

Sipas aktit te ekspertimit toksikologjik nr. 2285, date 22.09.2021 ka rezultuar se: Ne mostren e urines se marre shtetasit Marios Dyli u zbulua prania e produkteve te metabolizmit te Cocaines, ne organizmin e njeriut.

Sa siper organi i akuzes cmon se ne rastin konkret i pandehuri Marios Dyli perdorues i saj ka konsumuar elementet e vepres penale te "Prodhimi dhe shitje e lendeve narkotike" sipas nenit 283/1 i K.P .

Faktet e përmendura më lart rezultuan të provuara me aktet e paraqitura nga organi i prokurorisë, të cilat për shkak të gjykimit me procedurë të shkurtuar marrin vlerën e provës në gjykim (qëndrim i cili është mbajtur edhe nga Gjykata e Lartë me vendimin unifikues nr 2 datë 29.01.2003). Konkretisht :

- Nga procesverbali i kapjes në flagrancë të të pandehurit datë 02.09.2021 rezulton e provuar koha dhe vendi i kapjes së të pandehurit, qeset me lëndë narkotike e gjetur të pandehurit në momentin e ndalimit, sendet e tjera të sekuestruara, etj.
- Nga procesverbali i përshkimit dhe peshimit të lëndës së sekuestruar dhe nga procesverbali i sekuestrimit të saj datë 02.09.2021 janë përshkruar hollësisht lënda e sekuestruar, pesha e detajuar e saj me dhe pa ambalazh, është pëshkruar mënyra e ambalazhimit, etj.
- Nga akt ekspertimi toksikologjik është bërë analizimi i urinës së të pandehurit dhe është arritur në konkluzionin se në urinën e tij u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të kokainës.
- Nga akt ekspertimi kimik i materialit bimor është bërë analizimi i lëndës së sekuestruar të pandehurit dhe është arritur në konkluzionin se pluhuri i analizuar tregon për praninë e kokainës.

Gjatë hetimeve paraprake, vetë i pandehuri, nuk e ka kundërshtuar akuzën duke pretenduar se është përdorues i lëndës narkotike dhe lënda e gjetur ishte për përdorim vetiak. Të njejtin qëndrim pohues dhe pendues i pandehuri ka mbajtur edhe në gjykimin e çështjes.

Sa më sipër Gjykata krijon bindjen se provat janë të plota, të harmonizuara dhe krijojnë bindjen se i pandehuri Marios Dyli ka kryer veprën penale të mbajtjes së lëndëve narkotike parashikuar nga neni 283 pg.1 i kodit penal. I pandehuri me dashje ka mbajtur një sasi lënde të

klasifikuar ligjërisht si narkotike pa qenë i pajisur me leje përkatëse apo për shkaqe të justifikuara.

I pandehuri me veprimet e tij të kundraligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme ka cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar kontrollin mbi lëndët narkotike dhe psikotrope si edhe rendin publik në përgjithësi. I pandehuri është në gjendje të kuptojë dhe kontrollojë veprimet e tij dhe pasojat që vijnë prej tyre, ka mbushur moshën 18 vjec dhe prandaj duhet të përgjigjet penalisht.

Në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit Gjykata mban parasysh rrezikshmërinë e veprës dhe të pandehurit. Kështu :

- Vepra penale e prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike po haset vazhdimisht dhe është një nga problemet shqetësuese i realitetit shoqëror shqiptar,
- Sasinë dhe llojin e lëndës narkotike të gjetur të pandehurit,
- Rrethanat e gjetjes së saj,
- Faktin se i pandehuri është përdorues i lëndëve narkotike
- Mënyrën e jetesës së të pandehurit si edhe
- Qëndrimin pohues dhe pendues të të pandehurit.

Duke i marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e mësipërme, Gjykata vlerëson se i pandehuri Marios Dyli duhet të dënohet me minimumin e dënimit të parashikuar nga neni 283 pg.1 i kodit penal. Nisur nga rrethanat e mësipërme, Gjykata vlerëson se ndaj tij mund të zbatohen dënimet alternative të dënimit me burgim, pasi rehabilitimi i të pandehurit, ndëshkimi i tij si edhe parandalimi i veprave të tjera mund të realizohet edhe me anë të kontakteve me shërbimin e provës pa qenë e domosdoshme izolimi nga shoqëria i të pandehurit.

Në bindjen e brendshme të Gjykatës ndikon edhe fakti se vetë organi i Prokurorisë ka kërkuar të njejtin lloj dhe masë dënimi.

Për shkak të gjykimit me procedurë të shkurtuar, i pandehuri përfiton edhe uljen e 1/3 së dënimit sipas parashikimeve të nenit 406 të K.pr.penale.

Lidhur me provat materiale, qarkullimi i lëndës narkotike është i ndaluar dhe në zbatim të nenit 190 të k.pr.penale duhet të urdhërohet asgjësimi i saj.

Për këto arsye, Gjykata krioji bindjen dhe bazuar në nenin 379 dhe 390 të K.Pr.penale

VENDOSI

Deklarimin fajtor të të pandehurit Marios Dyli (i biri Bilbil dhe Margarita, i dtl 28.12.1996) për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike parashikuar nga neni 283 pg.1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim.

Në zbatim të nenit 406 të K.pr.penale ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri Marios Dyli dënohet me 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim.

Bazuar në nenin 59 dhe 60 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimi, me kusht që i pandehuri Marios Dyli për një periudhë prove prej 3 (tre) vjet të mos kryejë veprë tjetër penale, të mos shoqërohet me persona të dënuar si edhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës.

Në zbatim të nenit 389 të k.pr.penale masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” në ngarkim të të pandehurit Marios Dyli caktuar nga Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 1529 rregj them, datë 04.09.2021, deklarohet e hequr.

Bazuar në nenin 190 të k.pr.penale prova materiale 1.8 (një pike tetë) gramë lëndë narkotike kokainë të asgjeshet, ndërsa provat e tjera t'i kthehen personave që u përkasin.

Shpenzimet procedurale i ngarkohen të pandehurit Marios Dyli.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim nga i pandehuri dhe/ose prokurori në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall me 30.03.2022

Sekretare

Mimoza Noka

GJYQTAR

Albert MEÇA

Shpenzimet gjyqesore

Fletethirje nje cope 150(njeqind e pesedhjete) leke

Shpenzime hetimore 1300(nje mije e treqind)leke